



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË
SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE TE BRENDSHME**

Nr. 34/1 prot

Tiranë, më 31.01 2023

Relacion për Monitorimin 12-mujori 2022

Qendra Kombëtare e Kulturore për Fëmijë ka për qëllimin edukimin dhe argëtimin e fëmijëve, kultivimin e prirjeve, talenteve, formimin e shprehive dhe shkathtësive. QKKF shërben për njohjen, ruajtjen dhe forcimin e traditës kombëtare, edukon atdhedashurinë, si dhe ndihmon për njohjen e vlerave të kulturës botërore.

Në shërbim të edukimit dhe argëtimit, zhvillimit të lirë të mendimit dhe krijimit, talentit dhe aftësimit, QKKF organizon veprimtari shkollore e ndërshkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare si: konkurse, olimpiada, festivale, ekspozita, ekskursionë, promovime librash, takime me shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, aktorë, etj.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 QKKF, TK ka vënë TK ka vënë në skenë 4 premiera artistik "Djali miljarder", Borëbardha dhe 7 xhuxhat", "Hirushja" dhe "Zonjush Plastika" si dhe janë zhvilluar disa aktivitete si:

- Festivali kombëtar i këngës tradicionale shqiptare 2 netë tek Liceu Artistik
- Projekti "Ngjyrat e nentorit" me pjesëmarrjen e fëmijëve të Qendrës së fëmijëve
- Klipi i vitit të ri me pjesëmarrjen e fëmijëve të Qendrës së fëmijëve
- Koncert me këngë dhe pjesë instrumentale - Fëmijët e kursit të këngës/muzikës të QKKF - Mikro Folie, Kryeministria.
- Koncert festiv me fëmijët e kursit të këngës dhe muzikës të QKKF-skena e T.Kukullave.
- Ekspozitë me fëmijët e kursit të pikturës dhe skulpturës së QKKF në Hollin e T.Kukullave dhe në Galerinë e Arteve.
- Aktivitet në kuadër të ditës ndërkombëtare të librit. Me pjesëmarrjen e fëmijëve të QKKF.
- Shfaqja "Përse u zëmeruan shkronjat"- me trupën e teatrit të kukullave.
- Koncert festiv me pjesëmarrjen e fëmijëve të QKKF - Mikro Folie, Kryeministria.
- Ekspozitë me punime skulpture tek Reja
- Festivali mbarëkombëtar i teatrit për fëmijë në qytetin e Beratit
- Festivali i kërcimit tek parku i Liqenit
- Koncert për piano QKKF
- Koncert festiv për Maratonën e VI-të të Tiranës
- Ekspozite me fëmijët e kursit të pikturës QKKF etj.

Fondi buxhetore i planifikuara për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është realizuar në masën 99.93 % e paraqitur edhe në tabelën e mëposhtme, sipas artikujve buxhetorë dhe nivelit të realizimit të tyre në vlerë dhe në përqindje:

NR.	Emertimi i Shpenzimit	Plani Buxhetor	Fakti Buxhetor	% e realizimit te Buxhetit
1	Shpenzime Paga	23,980,000	23,963,266	99.93
2	Shpenzime sigurime shoqerore	4,003,000	3,994,717	99.79
3	Shpenzime operative	5,626,650	5,626,650	100.00
4	Shpenzime Cilesi Artistike	3,718,350	3,718,350	100.00
	Totali	37,328,000	37,302,983	99.93

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është realizuar në masën 99.86 %. Numri i punonjësve të QKKF-së për 12 mujorin e vitit 2022 ka qënë 30 punonjës sa është edhe organika dhe një punonjës me kontratë të përkohshme mbi organikë.

Treguesit e performancës:

I. Produkti i I-rë Numri i shfaqjeve teatrale të dhëna

QKKF ka bërë përpjekjet maksimale për të realizuar sa më shumë shfaqje teatrale si brenda Tiranës ashtu edhe nëpër qytete të tjera pasi për shkak të kohë zgjatjes së pandemisë kërkesat e femijëve për shfaqjet teatrale kanë ardhur gjithnjë e në rritje. Për vitin 2022 ky tregues është realizuar 65%, nga 280 shfaqje të planifikuara për tu shfaqur gjatë vitit 2022 janë dhënë vetëm 181.

Arsyeja kryesore e mosrealizimit të këtij treguesi pasi Teatri i Kukullave është në rikonstruksion dhe shfaqjet jepen në sallë e Liceut artistik vetëm ditën e shtunë dhe të diel duke respektuar kalendarin artistik të Liceut Artistik.

II. Produkti i II-të Numri i projekteve dhe aktiviteteve artistike të realizuara

Treguesi i Produktit II është realizuar 142 % pasi për shkak të situatës emergjente të COVID 19 aktivitete për vitin 2022 janë rritur nisur nga kërkesat e madhe për aktivitete artistike dhe kulturore që ka patur pas pandemisë si dhe angazhimit maksimal të institucionit duke siguruar fonde shtesë nga sponsorizimi i Raiffesen bank.

III. Produkti i III-të Numri i femijëve të regjistruar në kurset artistike

Ky tregues është realizuar 55 % edhe pse aktivitetet me femijët e qendrës kanë ardhur duke u rritur gjatë vitit 2022. Në mosrealizimin e këtij produkti ka ndikuar kthimi me një turn i mësimdhënies në shkolla, angazhimi i femijëve pas shkollës si edhe ndryshimi i specialistëve të artit pasi tre specialiste mësimdhënëse të qendrës kanë qënë me leje lindje.

PËRGJ. SEKTORIT TË FINANCËS
ADELINA AVDULAJ



DREJTOR I PËRGJITHSHËM
AGIM BAJKO


